

Viqë/Viça e kanë gjetur trupin e masakruar të Dautit te vendi i quajtur *Katund/Katun*, në afërsi të lagjes serbe *Krstić*. Në tërë trupin i shiheshin plagët dhe shpimet nga plumbat në kokë, qafë dhe gjoks, ndërkaq duart i kishte të thyera. Në vendin ku e kishin gjetur, ndodheshin edhe mbetjet e kokës së tij. Një trup peme pranë trupit ishte i shpuar nga plumbat. Dautin e kanë varrosur në varrezat e fshatit të tij.

**Burimet:** deklarata N.R, FDH-8114; deklarata N.R, FDH-37120; deklarata I.B, FDH-37119.

---

### **Sami (Muharrem) Bakiu**

(20.04.1971, shqiptar nga Bitia e Epërme/Gornja Bitinja, komuna e Shtërpçës/Štrpce, i pamartuar, tre fëmijë)

Samiu ka shkuar te i vëllai Ismajli në Gjermani në vitin 1993. Ismajli u kthye në Kosovë në vitin 1997, ndërkaq Samiu në muajin shkurt të vitit 1998. Samiu me bashkëshorten Shemsijen, fëmijët Mirjetën, Mimosën dhe Dardanin, jetonin në bashkësi familjare me prindërit e tij dhe vëllain Islamin me familje. Në datën 28.09.1998, rreth orës 6:00, Samiu e ka çuar të atin në spital në Prishtinë/Priština. Nga ora 8:00, forcat serbe kanë hyrë në fshatin **Biti e Epërme/Gornja Bitinja**. E kanë marrë Ismajlin dhe e kanë

çuar në Stacionin e Policisë në Shtërpçë/Štrpce, ndërkaq familjarët e tij, si dhe bashkëfshatarë të tjerë, i kanë përzënë nga shtëpitë e tyre. Familjarët e Samiut dhe të Ismajlit u strehuan në Ferizaj/Uroševac. Diku nga ora 12:00 [28.09.1998], Samiu u kthye në fshat, ku ende gjendeshin forcat serbe. Më komshiun Idrizin dhe vajzën e tij Violeten ishin të strehuar në ahurin e tyre deri në ora 16:30, kur në oborr kanë hyrë pjesëtarët e forcave serbe. Idrizi dhe Violeta ikën me vrap në njërën, ndërkaq Idrizi në anën tjetër. Disa ushtarë e kanë zënë Violeten dhe e kanë futur në oborrin e Samiut, ku gjendej edhe ai. Kishte parë sesi ushtarët e rrihnin Samiun. Menjëherë pas kësaj, ushtarët e kanë çuar Samiun me xhip, ndërkaq ajo, pas shkuarjes së ushtarëve, doli në rrugë dhe iu bashkëngjiti fshatarëve që po e braktisnin fshatin. Në datën 3.10.1998, kushërinjtë Nuhiu dhe Sylejmani e kanë gjetur trupin e masakruar të Samiut në oborrin e tij. Kishte therje thike nëpër tërë trupin. E njoftuan Ismajlin, i cili në ndërkohë u lirua nga stacioni policor. Një ditë më vonë, Ismajli me ndihmën e farefisit e kanë varrosur Samiun në varrezat e fshatit.

**Burimet:** deklarata I.B, FDH-37119; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 146, FDH-23857.

---